



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjekti:

Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Llogaria e Buxhetit Themelor 631

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i paitueshmërisë për vitin 2020

Qëllimi i revizionit: të fitohet bindje e arsyeshme nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet që reflektojnë në raportet financiare janë në gjitha aspektet materiale, në pajtim me rregullativën ligjore përkatëse udhëzimeve dhe politikave të vendosura.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- nuk është vendosur evidenca përkatëse e të hyrave;
- janë paguar të hyra më pak në vlerë prej 12.861 mijë denarë në procedurën për regjistrimin e mjeteve shëndetësore;
- janë paguar 3.767 mijë denarë për angazhimin e personave me kontratë për punë pa i definuar saktësisht kualifikimet profesionale dhe detyrat e punës dhe pa dëshmi për kryerjen e punës;
- janë formuar 13 komisione të parakohshme në të cilat janë anëtarë edhe punonjësit e MALMED aktivitete e të cilëve janë pjesë e punës së rregullt, për të cilat janë paguar 4.652 mijë denarë.

Rekomandimet kyçe:

- Vendosjen e evidencës së kontabilitetit analitik për të gjitha të hyrat;
- Arkëtimi i shtesës për regjistrim në regjistrin e mjeteve shëndetësor të kryet për çdo produkt një nga një;
- Definimi i qartë i kualifikimeve profesionale dhe detyrave të punës të personave të angazhuar me kontratë pune;
- Aktivitetet në komisionet e përkohshme të mos jenë pjesë nga detyrat e rregullta të punës.

Mendimi i dhënë *:

Është shprehur mendim i pavolitshtëm në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Është e nevojshme të rregullohen aktet ligjore dhe nënligjore në drejtim të:

- Definimit të afateve për të vepruar në disa pjesë të procedurave për lëshimin e certifikatave dhe miratimeve;
- sigurimi i transparencës në mënyrën se si kryhen provat klinike dhe përcaktimi i përqindjes së pjesëmarrjes të fondeve që duhet të jenë të ardhura të ISHP-së
- Ndryshimi i Ligjit për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore me qëllim që të lehtësohet vendosja në treg e barnave për trajtimin e sëmundjeve që do të shkaktonin epidemi ose pandemi.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft Raportin e Revizorit të Autorizuara Shtetëror.

*  pozitive,  me rezervë,  të pavolitshtëm,  të përmbajtur